



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 386/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Bashkimi Demokratik (BD), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KTDP), dega në Prizren, për shkak të mbulimit të posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.11.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Bashkimit Demokratik (BD), dega në Prizren, kështu që Kosova Turk Demokratik Partisi (KTDP), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

Me datën 30.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Bashkimi Demokratik (BD), në të cilën theksohet se Partia KDTP në Prizren ka bërë mbulimin dhe dëmtimin e posterëve të Bashkimit Demokratik në lagjen Jenimahall me çka edhe ka bërë shkelje të LZP-së përkatësisht nenit 33 pika a.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik Kosova Turk Demokratik Partisi (KTDP), me datën 30.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 02.10.2013.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, nuk pranoi pranoi përgjigjen në ankesë nga KTDP, sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e bazuar**

Sipas parashtruesit të ankesës, BD se në lagjen Jenimahall partia KTDP ka bërë mbulimin dhe dëmtimin e posterëve të subjektit tonë BD, ku me këtë veprim kanë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika a) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterët e subjektit politik BD janë të mbuluara me posterët e subjektit politik KTDP, të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e partisë KTDP është shkelur neni 4.1 pika a) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe neni 33 pika a) të LZP-së, pasi që posterat e subjektit politik BD janë dëmtuar dhe janë mbuluar me posterat e subjektit politik KTDP, veprime këto që e bëjnë përgjegjëse subjektin politik KDTP andaj mbi këtë bazë gjë e cila ka ndikuar në caktimin lartësisë së gjobës së shqiptuar, si dhe në mbështetje te neni 120 paragrafi 1 pika c), dhe neni 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 386/2013 më datën 04.11.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Nehat Idrizi**



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda një-etekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*